



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:209658

Datë: 02.12.2020

Numri i dokumentit: 01372651

**P.nr.1004/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit R.T., për shkak se në bashkëkryeje ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1497-2/19, e dt.23.09.2019, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë 16.11.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarit R.K. dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 02.12.2020, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri R.T., nga i ati ....., e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me dt. .... në fshatin .... K Shtime, ku dhe tani jeton, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ka qenë në arrest shtëpiak nga dt. 25.08.2019 gjer me dt. 23.09.2019.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më datë 24.08.2019 rreth orës 17:00, në picerinë “....” në rrugën e “Reçakut” në Ferizaj, së bashku me të pandehurin A.... i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit

R.K., ashtu që deri sa të pandehurit kanë qenë të ulur në piceri, me të vërejt të dëmtuarin, së pari i pandehuri A.... ngritët në këmbë ja zgjat dorën të dëmtuarit dhe i drejtohet me fjalët “nuk ka vy me mi pru policinë në shpi” dhe aty papritmas fillon ta godasë ate me dorën e majtë, në pjesë të pasme tek veshi në anën e djathtë, e pastaj i pandehuri R.T. e godet me grushta dhe me shqelma në fytyrë deri sa ai ka qenë i shtrirë në tokë, e si pasojë e këtyre goditjeve i dëmtuari pëson lëndime dhe ate ndrydhje të indeve të buta të regjionit i dor të qafës, të cilat lëndime në akt ekspertimin mjeko-ligjor, të dat.02.9.2019,janë cilësuar si dëmtime të lehta trupore.

Me këtë në bashkëkryeje ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 38, 46,47, 48,49, 69 ,70 dhe 185 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 365 ,453 dhe 463 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

## **G J Y K O N**

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, në të cilin dënim të shqiptuar me burg do të llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 25.08.2019 gjer me dt. 23.09.2019, dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet me kusht që nëse i pandehuri në afat prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit).

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë Euro/ si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore) shumën prej 20 Euro /njëzet euro/,në afatin prej 30 ditëve,dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Po ashtu obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej nga 30 Euro /tridhjetë/, po ashtu brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari R.K. nga Lipjani, rruga “....” , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

II. Për të pandehurin A.T, me pëlqimin e Prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit dhe të pandehurit R.T., konform nenit 36 të KPPRK-së, veçohet procedura, për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës së tij në gjykatë.

Për të pandehurin A.T. nga fsh. .... K. Shtime,do të formohet dhe regjistrohet lëndë e re në regjistrat e gjykatës të divizionit penal dhe e njëjta lëndë do të merr numër të ri.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP.II.nr.1497-2/19, e dt.23.09.2019, ka ngarkuar të pandehurit R.T. dhe A. T, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe tu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj .

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar, i pandehurit gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale konform nenit 245 par. 1 të KPPRK-së , ka caktuar seanca për shqyrtimin fillestar, por i pandehuri A.T. nuk është paraqitur në seancat gjyqësore dhe nga fletëkthesat për dorëzim personal, gjykata është njoftuar se i pandehuri momentalisht jeton jashtë shtetit-në Gjermani.

Gjykata me datë. 16.10.2019,ka kërkuar nga Stacioni i policisë në Shtime që të verifikojë se i pandehuri a gjendet në vendbanimin e tij apo me të vërtetë gjendet jashtë shtetit siç është konstatuar në fletëkthesa. Stacioni i Policisë në Shtime ka njoftuar gjykatën në bazë memorandumit zyrtar REF:04/1-05SH-O-201/19, të datës 07.11.2019,se i pandehuri A.T. është përkohësisht me punë në Gjermani.

Gjykata më datë 16.11,2020,ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe i pandehuri R.T. dhe pas njoftimit që ju ka bërë të njëjtëve se i pandehuri A.T. për momentin gjendet me punë në Gjermani, palët e sipërpërmendura për shkak të ekonomizimit të procedurës janë pajtuar që të veçohet procedura penale kundër A.T.

Gjykata pasi ka marrur mendimin e palëve, me Aktvendim të veçantë të dt.16.11.2020, ka veçuar procedurën penale për të pandehurin A.T. nga fsh. .... , për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka vendosur që për te të formohet lëndë e re penale dhe që e njëjta të merr numër të ri në regjistrat e gjykatës në divizionin penal, kurse me të pandehurin R.T. ka vazhduar shqyrtimin fillestar për bashkëkryerje të veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën janë akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë.

Në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur më dt.16.11.2020, në mbështetje të nenit 245 par. 2 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i pandehuri në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjen e aktakuzës nga Prokuroria Themelore në Ferizaj dhe më tej e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij të parapara në nenin 246 par. 1 të KPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në kuptim të nenit 246 par. 3 të KPRK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga Prokurori i shtetit dhe kur gjykata është bindur se i pandehuri ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 246 par. 4 të KPRK-së, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranojnë fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë sipas aktakuzës për të gjitha pikat e sajë, ndihem thellë e penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, me të dëmtuarin R.T. jam njohur më parë në bazë të vëllezërve të tij me të cilët kam punuar dhe përmes tyre e kam njohur R.T., pas rastit që na ka ndodhur unë i kam kërkuar falje R.T. përmes disa miqve tonë, por i njëjti nuk ka pranuar kërkim faljen tonë dhe për tu pajtuar me ka kërkuar para, është hera e parë që kam kryer vepër penale dhe që jam në procedurë në gjykatë dhe po premtoj se në të ardhmen më nuk do të përsërisë kesi lloj vepre penale apo të ngjashme dhe unë për këtë rast jam që me R.T. ti rregullojmë raportet në mes vete.

Prokurori i shtetit me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPRK-së, mbështetet në provat dhe faktet që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit si: deklarata e të pandehurit A.T. e dhënë në prokurori me dt.27.08.2019,deklaratat e të dëmtuarit R.K., njëra e dhënë në polici e dt. 25.08.2019, kurse tjetra e dhënë në procedurë paraprake në Prokurorin Themelore Ferizaj me dt.18.09.2019, deklarata e dëshmitarit T.Q. e dt. 25.08.2019 e dhënë në polici, deklarata e të pandehurit R.T. e dhënë në polici me dt. 25.08.2019, raporti mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Qendra Emergjente në Ferizaj me numër të protokollit 766 i dt. 25.08.2019, akt ekspertiza mjeko ligjore e dt. 05.09.2019, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të kryerjes në bashkëkryerje të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpall fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese përkatësisht që në shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj vepre penale dhe se i pandehuri për herë të parë kanë ra ndesh me ligjin, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 1004/19 e datës 02.12.2020**

**Zyrtare Ligjore**  
**Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.